

**VENDIM**  
**Nr. 430, datë 11.7.2018**

**PËR KRIJIMIN E BAZËS SË TË DHËNAVE SHTETËRORE PËR SISTEMIN  
ELEKTRONIK TË LEJEVE  
(E-LEJE)**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 4, të ligjit nr. 10325, datë 23.9.2010, “Për bazat e të dhënave shtetërore”, dhe të ligjit nr. 107/2014, “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Krijimin e bazës Së të dhënave shtetërore për sistemin elektronik të lejeve (sistemi *e-Leje*), për të gjitha kërkesat dhe lejet, sipas legjislacionit të planifikimit dhe të zhvillimit të territorit.

2. Institucioni që administron informacionin në sistemin elektronik të lejeve është Agjencia e Zhvillimit të Territorit (AZHT), në cilësinë e sekretariatit teknik të Këshillit Kombëtar të Territorit, që ka akses në sistemin elektronik të lejeve (*e-Leje*), në drejtim të verifikimit të të dhënave parësore dhe dytësore që kjo bazë të dhënash grumbullon, si dhe të përmirësimit të procedurave që kryhen nëpërmjet sistemit elektronik.

3. Agjencia e Zhvillimit të Territorit ka këto kompetenca:

a) Ofron asistencë ligjore dhe procedurale ndaj bashkive dhe institucioneve të përfshira në sistemin *e-Leje*;

b) Trajnon, kur është e nevojshme, me kërkesë të autoriteteve publike, stafin e bashkive dhe institucioneve;

c) Miraton listat dhe formularët TIP të dokumentacionit që do të kërkohen nga autoritetet vendore, për aplikimet *online*, për çdo shërbim që ofrojnë, në përputhje me kushtet dhe kriteret e përcaktuara në ligjin nr. 107/2014, “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, të ndryshuar, dhe vendimin nr. 408, datë 13.5.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, të ndryshuar;

ç) Harton protokolle pune mbi bazën e marrëveshjeve të shërbimit, për informacionin që do të ofrohet nga autoritetet vendore të zhvillimit të territorit apo/dhe institucionet e përfshira në sistemin *e-Leje*, për aplikimet *online*, për çdo shërbim që ofrojnë, në përputhje me kushtet dhe kriteret e përcaktuara në ligjin nr. 107/2014, “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, të ndryshuar, dhe vendimin nr. 408, datë 13.5.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, të ndryshuar;

d) Shërben, në bashkëpunim me AKSHI-n, si burim informacioni dhe suporti (*Help Desk*) për shërbimet që ofrohen nëpërmjet sistemit. Niveli i këtij bashkëpunimi rregullohet me marrëveshje të përbashkët ndërmjet dy institucioneve.

dh) Merr në shqyrtim reklamimet e aplikuesve ndaj procedurave nëpërmjet sistemit elektronik të lejeve, që autoritetet vendore të zhvillimit kryejnë, në procesin e aplikimeve për leje zhvillimi/ndërtimi dhe çdo aplikimi tjetër në sistemin *e-Leje*.

4. Të dhënat e sistemit *e-Leje* janë, si më poshtë vijon:

4.1 Të dhënat parësore të sistemit *e-Leje* përfshijnë tipologjitë e lejeve/e shërbimeve:

a) Deklaratë paraprake për kryerje punimesh;

b) Leje zhvillimi;

c) Leje ndërtimi për ndërtime të reja me sipërfaqe deri në 250 m<sup>2</sup> për bashki dhe KKT;

ç) Leje ndërtimi për ndërtime të reja me sipërfaqe më të madhe se 250 m<sup>2</sup> për bashki dhe KKT;

d) Leje ndërtimi infrastrukture për bashki dhe KKT;

dh) Leje ndërtimi për shtesë në ndërtim ekzistues me sipërfaqe deri në 250 m<sup>2</sup> për bashki dhe KKT;

e) Leje ndërtimi për shtesë në ndërtim ekzistues me sipërfaqe më të madhe se 250 m<sup>2</sup> për bashki dhe KKT;

- ë) Leje ndërtimi për rikonstruksion pa ndryshim funksioni për bashki dhe KKT;
- f) Leje ndërtimi për rikonstruksion me ndryshim funksioni për bashki dhe KKT;
- g) Leje për ndryshimin e projektit gjatë ndërtimit për bashki dhe KKT;
- g) Leje ndërtimi për prishje të ndërtimit ekzistues për bashki dhe KKT;
- h) Leje për shtyrjen e afatit të lejes së ndërtimit për bashki dhe KKT;
- i) Leje për ndryshimin e funksionit për bashki dhe KKT;
- j) Leje për ndryshimin e subjektit zhvillues për bashki dhe KKT;
- k) Njoftim për fillimin e punimeve;
- l) Njoftim për raportin e mbikëqyrjes;
- ll) Njoftim për raportin e kolaudimit;
- m) Njoftim për ndryshimin e subjektit zbatues;
- n) Certifikatë përdorimi për bashki dhe KKT.

#### 4.2 Të dhënat dytësore të aplikimit që merren nga ndërveprimi:

##### a) Të dhënat e aplikantit si subjekt tregtar:

- NUIS;
- emri i subjektit.

##### b) Të dhënat e aplikantit si individ:

- emri;
- mbiemri;

##### c) Të dhënat e aplikantit si institucion:

- NUIS;
- emri i institucionit.

##### ç) Të dhënat e licencës së projektuesit:

- NUIS;
- nr. licence.

#### 4.3 Të dhëna të tjera, si data dhe numri i aplikimit.

#### 4.4. Të dhënat e marra nga formati i aplikimit:

##### a) Të dhëna të aplikantit marrë nga formati i aplikimit:

- prefektura/qarku, njësia administrative, bashkia;
- kodi postar;
- nr. banese;
- cel., *e-mail* (individ, institucion, subjekt).

##### b) Të dhëna të zhvilluesit marrë nga formati i aplikimit:

- prefektura/qarku, njësia administrative, bashkia;
- kodi postar;
- nr. banese;
- cel., *e-mail*.

##### c) Të dhëna të pronës marrë nga formati i aplikimit:

- numri i zonës kadastrale;
- numri i pasurisë/vërtetimit hipotekor;
- lloji i pronësisë;
- adresa.

##### ç) Përshkrimi i punimeve marrë nga formati i aplikimit:

- emërtimi i objektit;
- përshkrimi i punimeve;
- vlera e investimit;
- sipërfaqja totale e ndërtimit mbi nivelin e tokës;
- sipërfaqja e tokës e zënë nga struktura;

- lartësia maksimale nga niveli 0 i ndërtimit;
  - numri i kateve mbi nivelin e tokës;
  - numri i kateve nën nivelin e tokës;
  - përdorimi i propozuar.
- d) Grupi i projektimit marrë nga formati i aplikimit:
- prefektura/qarku, njësia administrative, bashkia;
  - kodi postar;
  - kategoria;
  - cel., *e-mail*.

dh) Dokumentacioni i detyrueshëm i përcaktuar në ligjin nr. 107/2014, “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, të ndryshuar, dhe vendimin nr. 408, datë 13.5.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, të ndryshuar.

5. Dhënësi i informacionit, sipas rolit/nivelet të aksesit, për subjektet e interesuara në sistemin *e-Leje*, është:

- a) “Administrator”, rol në sistemin *e-Leje* i cili realizon konfigurimet e përdoruesve për autoritetin përgjegjës;
- b) “Aplikues”, person fizik apo juridik dhe institucione, të cilët regjistrohen në portalin *e-Albania*, për të kryer një aplikim në sistemin *e-Leje*;
- c) “Protokollues”, rol në sistemin *e-Leje*, i cili merr aplikimin, vendos numrin e protokollit dhe kalon aplikimin tek roli pasardhës;
- ç) “Nëpunës”, rol në sistemin *e-Leje*, i cili shqyrton aplikimin sipas legjislacionit në fuqi për planifikimin dhe zhvillimin e territorit dhe e dërgon për konfirmim te roli i “kontrolluesit”;
- d) “Kontrollues”, rol në sistemin *e-Leje*, i cili rishikon aplikimin që i dërgon “nëpunësi” dhe e dërgon te “drejtuesi” për konfirmim;
- dh) “Drejtues”, rol në sistemin *e-Leje*, i cili shpërndan aplikimin te nëpunësi përkatës, shqyrton dhe rishikon aplikimin, si dhe e dërgon tek institucionet përkatëse për mendim;
- e) “Llogaritar”, rol në sistemin *e-Leje*, i cili përllogarit vlerën e taksës së ndikimit në infrastrukturë për aplikimin;
- ë) “Konfirmues i pagesës”, rol në sistemin *e-Leje*, i cili verifikon nëse është realizuar pagesa e taksës nga ana e aplikuesit;
- f) “Kryetar”, rol në sistemin *e-Leje* për aplikimet pranë bashkive që, merr vendim për miratimin apo refuzimin e aplikimit;
- g) “Drejtor i përgjithshëm”, rol në sistemin *e-Leje*, i cili për aplikimet pranë AZHT-së lëshon apo refuzon aplikimin, në përputhje me legjislacionin në fuqi për planifikimin dhe zhvillimin e territorit;
- gj) “Administrator i raporteve”, rol në sistem i cili gjeneron raporte/statistika lidhur me lejet përkatëse.

6. Institucionet që japin mendim në sistemin *e-Leje*, por pa u kufizuar, janë:

- Agjencia e Shërbimit Arkeologjik;
- Agjencia e Zhvillimit të Territorit;
- Agjencia Kombëtare e Mjedisit;
- Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura;
- Arkivi Qendror Teknik i Ndërtimit;
- Autoriteti Rrugor Shqiptar;
- Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore;
- drejtoritë e Agjencisë së Legalizimit, Urbanizimit dhe Integritit të Zonave/ Ndërtimeve Informale (Berat, Dibër, Durrës, Elbasan, Fier, Gjirokastër, Kamzë-Vorë, Kavajë, Korçë, Krujë, Kukës, Lezhë, Lushnjë, Sarandë, Shkodër, Tirana 2 (shtesat), Tirana Jug, Tirana Rurale, Tirana Veri, Vlorë, Zonat Turistike);

- inspektor në Inspektoratin e Mbrojtjes së Territorit, pranë bashkisë përkatëse;
  - Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit;
  - Instituti i Monumenteve të Kulturës;
  - Instituti i Ndërtimit;
  - Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural;
  - Ministria e Drejtësisë;
  - Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë;
  - Ministria e Kulturës;
  - Ministria e Mbrojtjes;
  - Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale;
  - Ministria e Turizmit dhe Mjedisit;
  - Ministria e Brendshme;
  - Ministria e Financave dhe Ekonomisë;
  - Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë;
  - “Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike” sh.a. (Berat, Burrel, Durrës, Elbasan, Fier, Gjirokastrë, Korçë, Shkodër, Tiranë, Vlorë);
  - Shërbimi për Mbrojtjen nga Zjarri dhe Shpëtimin në nivel qendror;
  - Shërbimi për Mbrojtjen nga Zjarri dhe Shpëtimin në nivel vendor (Belsh, Berat, Bulqizë, Cërrik, Delvinë, Devoll, Dibër, Divjakë, Dropull, Durrës, Elbasan, Fier, Finiq, Fushë-Arrëz, Gjirokastrë, Gramsh, Has, Himarë, Kamzë, Kavajë, Këlcyrë, Klos, Kolonjë, Konispol, Korçë, Krujë, Kuçovë, Kukës, Kurbini, Lezhë, Libohovë, Librazhd, Lushnjë, Malësi e Madhe, Maliq, Mallakastër, Mat, Memaliaj, Mirditë, Patos, Peqin, Përmet, Poliçan, Pogradec, Përrenjas, Pukë, Pustec, Rogozhinë, Roskovec, Sarandë, Selenicë, Shijak, Shkodër, Skrapar, Tepelenë, Tiranë, Tropojë, Ura Vajguore, Vau i Dejës, Vlorë, Vorë);
  - “Ujësjellës-Kanalizime” sh.a. (Belsh, Berat, Sarandë, Bulqizë, Cërrik, Delvinë, Devoll, Dibër, Divjakë, Dropull, Durrës, Elbasan, Fier, Finiq, Fushë-Arrëz, Gjirokastrë, Gramsh, Has, Himarë, Kamzë, Kavajë, Këlcyrë, Klos, Kolonjë, Konispol, Korçë, Krujë, Kuçovë, Kukës, Kurbini, Lezhë, Libohovë, Librazhd, Lushnjë, Malësi e Madhe, Maliq, Mallakastër, Mat, Mirditë, Patos, Peqin, Përmet, Pogradec, Poliçan, Pukë, Pustec, Rogozhinë, Roskovec, Selenicë, Shijak, Shkodër, Skrapar, Tepelenë, Tiranë, Tropojë, Ura Vajguore, Vau i Dejës, Vlorë, Vorë);
  - zyrat vendore të regjistrimit të pasurive të paluajtshme (Berat, Bulqizë, Devoll, Durrës, Elbasan, Ersekë, Fier, Gjirokastrë, Gramsh, Has, Kavajë, Korçë, Krujë, Kuçovë, Kukës, Laç, Lezhë, Librazhd, Lushnjë, Malësi e Madhe, Mallakastër, Mat, Mirditë, Peqin, Përmet, Peshkopi, Pogradec, Pukë, Sarandë, Shkodër, Skrapar, Tepelenë, Tiranë, Tropojë, Vlorë).
7. Sistemi *e-Leje* ndërvepron me bazat e të dhënave shtetërore, si më poshtë:
- a) Regjistrin Tregtar, administruar nga QKB-ja;
  - b) Regjistrin Kombëtar të Licencave, Autori-zimeve dhe Lejeve, administruar nga QKB-ja;
  - c) Regjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile, administruar nga Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile;
  - ç) Regjistrin Elektronik të Tatimeve, administruar nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, vetëm për informacionin e përgjithshëm.
8. Dhënësi i informacionit të tretëve, për këtë sistem, është Drejtoria e Asistencës së Njësive të Qeverisjes Vendore, pranë Agjencisë së Zhvillimit të Territorit.
9. Sistemi *e-Leje* garanton përdorimin e sistemit elektronik të lejeve nga të gjithë aplikuesit dhe institucionet e përfshira, me qëllim thjeshtimin e procedurave dhe ofrimin e shërbimit me një ndalesë, në kuadër të ushtrimit të funksionit të kontrollit të zhvillimit të territorit, në përputhje me legjislacionin për planifikimin dhe zhvillimin e territorit.
10. Të gjitha aplikimet për leje në Republikën e Shqipërisë, sipas ligjit nr. 107/2014, “Për

planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, të ndryshuar, dhe akteve nënligjore në zbatim të tij kryhen nëpërmjet sistemit elektronik të lejeve, në portalin *e-Albania*.

11. Korrigjimi i të dhënave të hedhura gabim në sistemin elektronik do të kryhet, si më poshtë:

a) Bashkitë apo institucionet, për të dhënat e hedhura gabim nga ana e tyre, i drejtohen me kërkesë zyrtare për korrigjimin Agjencisë së Zhvillimit të Territorit,

b) Agjencia e Zhvillimit të Territorit, pas një verifikimi paraprak, vlerëson nëse duhet të kryhet apo jo ndërhyrja përkatëse në sistemin *e-Leje* dhe i drejtohet zyrtarisht AKSHI-t.

c) AKSHI, pas kërkesës së AZHT-së, kryen korrigjimin/ndërhyrjen në sistem dhe njofton AZHT-në.

12. Në të gjitha rastet kur në sistem janë hedhur disa aplikime identike, me subjekt, kërkesë apo të dhëna të tjera të njëjta, atëherë do të procedohet me aplikimin fillestar.

13. Afati ligjor për kryerjen e korrigjimit do të jetë 3 (tri) ditë pune. Ky afat pezullon afatet në sistemin elektronik për subjektin që ka kërkuar ndreqjen e gabimit.

14. Për punonjësit e Agjencisë së Zhvillimit të Territorit, niveli i aksesit përcaktohet me urdhër të drejtorit të Përgjithshëm të AZHT-së.

15. Të gjitha ndryshimet në arkitekturën *software* dhe *hardware* të sistemit elektronik të lejeve (*e-Leje*) të cilat mund të ndodhin në varësi të nevojave të institucionit dhe praktikave evropiane dhe ndërkombëtare, në fushën e standardizimit, do të kryhen në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe vendimin nr. 673, datë 22.11.2017, të Këshillit të Ministrave, “Për riorganizimin e Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit”, të ndryshuar, dhe vendimit nr. 945, datë 2.11.2012, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregullores “Administrimi i sistemit të bazave të të dhënave shtetërore””.

16. Ngarkohen Agjencia e Zhvillimit të Territorit, në cilësinë e sekretariatit teknik të Këshillit Kombëtar të Territorit, Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit, autoritetet vendore të zhvillimit të territorit, ministritë, si dhe të gjitha institucionet e tjera publike të përfshira në procesin e miratimit të akteve që lëshohen nëpërmjet sistemit elektronik për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI  
**Senida Mesi**